



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Sh.II.nr.1420/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit Selmans Network SH.P.K., me seli në Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata” SH.P.K., me seli të zyrës në Prishtinë, kundër debitorit Posta e Kosovës SH.A., me seli në Prishtinë, me bazë juridike përbarimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.347/2022 të datës 26.09.2023, me datë 22.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit Selmans Network SH.P.K, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.347/2022 i datës 26.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.347/2022 të datës 26.09.2023, ka Pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Posta e Kosovës SH.A., ashtu që ka anuluar urdhrin përbarimor P.nr.961/2020 të datës 26.11.2020, të lëshuar nga përbaruesi privat Emine Sherifi-Lubeniqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa, të ndryshohet aktvendimi i ankimuar ashtu që të refuzohet prapësimi, apo i njëjti të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur debitori, duke e kundërshtuar ankesën e autorizuarit të kreditorit, me propozim që e njëjta të refuzohet dhe aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e autorizuarit të kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Selmans Network SH.P.K., me seli në Prishtinë, me datë 26.11.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit Posta e Kosovës SH.A., me seli në Prishtinë, në bazë të dokumenti të besueshëm – faturës nr. 417/2018 të datës 17.08.2028, faturës nr.72/2020 të datës 13.03.2020, faturës nr.110/2020 të datës 14.04.2020, faturës nr.137/2020 të datës 13.05.2020, faturës nr.221/2020 të datës 10.07.2020 dhe faturës nr.261/2020 të datës 05.08.2020, për shumën e përgjithshme në vlerë prej 2,668.66 Euro.

Përmbartuesi privat Emine Sherifi-Lubeniqi, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.961/2020 të datës 26.11.2020, ka lejuar përmbartimin kundër debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbartim.

Kundër këtij urdhri përmbartimor debitori me datë 03.12.2020 ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se debitori ka përmbushur në tërësi borxhin e kreditorit, ndërsa sa i përket pretendimeve për pagesa të pjesëshme të faturave objekt i këtij përmbartimi, ka sqaruar se debitori, në secilën faturë të pranuar në mënyrë të rregullt, ka aplikuar penallti për shkak të vonësive të kreditorit, ashtu që secilës faturë i është zbritur 10 % e vlerës së saj. Ndërsa, sa i përket faturës nr.137/20 të datës 13.05.2020, ka shtuar se e njëjta nuk është dorëzuar dhe pranuar asnjëherë në mënyrë të rregullt tek debitori, andaj si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbartim.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 10.12.2020, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e ngritura nga debitori, kjo për faktin se faturat objekt i këtij përmbartimi duhet paguar në tërësi në shumën e tyre, ndërsa zbritja prej 10% e bërë nga debitori nuk është mbështetur në asnjë marrëveshje për zbritje në mes të debitorit dhe kreditorit, dhe si e tillë është e njëanshme dhe e kundërligjshme.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.347/2022 të datës 26.09.2023, me të cilin ka Pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Posta e Kosovës SH.A., ashtu që ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.961/2020 të datës 26.11.2020, të lëshuar nga përmbartuesi privat Emine Sherifi-Lubeniqi.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet se fatura nr. 137/20 e datës 13.05.2020, si një (1) nga gjashtë (6) faturat mbi bazën e të cilës është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë

dokument i besueshëm për faktin se e njëjta nuk përmban vulën e pranimit të shkresave të debitorit në faturë, dhe as nënshkrimin e zyrtarit përgjegjës të debitorit, ndërsa në shkresat e lëndës nuk gjendet ndonjë provë tjetër përmes të cilës do mund të vërtetohet se fatura e lartcekur është dorëzuar nga kreditori dhe është pranuar nga debitori pa u kundërshtuar detyrimi që rrjedh nga kjo faturë. Në lidhje me këtë, sipas propozimit të kreditorit, Gjykata i ka dhënë mundësi këtij të fundit që në afat prej shtatë (7) ditësh të siguroj prova nga të cilat vërtetohet dorëzimi i faturës në fjalë tek debitori, por që edhe pas kalimit të këtij afati, kreditori nuk ka siguruar provat e pretenduara. Mbi këtë bazë gjykata konstatoj se fatura nr. 173/20 e datës 13.05.2020 në shumë prej 799.00 euro nuk është e përshtatshme për përmbnim dhe nuk paraqet bazë për lejimin e përmbnimit. Tutje, gjykata shqyrtoj përshtatshmërinë e faturave nr.417/2018 të datës 17.08.2028, nr.72/2020 të datës 13.03.2020, nr.110/2020 të datës 14.04.2020, nr.221/2020 të datës 10.07.2020 dhe faturën nr.261/20 të datës 05.08.2020, dhe gjeti se të njëjtat, po ashtu nuk paraqesin bazë për lejimin e përmbnimit, pasi që faturat e lartcekura në propozimin për përmbnim janë bashkangjitur nga kreditori pa nënshkrimin dhe vulën e debitorit, ndërsa përkundër që debitori me përgjigje ndaj prapësisimit, i ka bashkangjitur kopjen e këtyre faturave, secila nga e protokolluar dhe nënshkruar nga debitori, ky i fundit ka paraqitur kundërshtime sa i përket lartësisë së borxhit të pasqyruar në këto fatura.

Kështu debitori, pas pranimit të secilës nga faturat e lartcekura, përmes procesverbaleve për mirëmbajtjen hixhienike të hapësirave të datës 20.09.2018, datës 26.05.2020, datës 26.05.2020, datës 20.07.2020 dhe datës 17.08.2020 pjesë e shkresave të lëndës, duke vepruar sipas nenit 13 të kontratës publike kornizë të lidhur kreditorin për mirëmbajtjen hixhienike të hapësirave të debitorit, ka aplikuar penalitete kontraktuese për secilën faturë në emër të vonesave në ofrimin e shërbimeve nga kreditori, duke zbritur vlerën e secilës faturë prej 10 %, dhe ka paguar pjesën tjetër të faturave të lartcekura, fakt ky që vërtetohet nga transferet bankare të datës 12.11.2018 në vlerë prej 787.02 euro, transferit bankar të datës 03.12.2020 në vlerë prej 1518.10 euro, transferit bankar të datës 20.07.2020 në vlerë prej 719.10 euro, transferit bankar të datës 14.04.2020 në vlerë prej 1518.10 euro si dhe transferit bankar të datës 25.09.2020 në vlerë prej 1518.10 euro, dhe të cilat pagesa të pjesshme nuk janë kontestuese as për kreditorin. Në këtë drejtim, marrë parasysh faktin që debitori, në mbështetje të kontratës se lidhur me kreditorin, përmes menaxherit të kontratës ka aplikuar penalitete kontraktuese ndaj lartësisë së faturave objekt i këtij përmbnimit menjëherë pas pranimit të tyre, rezulton se i njëjti, nuk është pajtuar në tërësi me detyrimin që rrjedh nga këto fatura në vlerën e paraqitur, pasi që përkundër vënies së vulës së pranimit të shkresave në këto fatura, të njëjtat i ka kundërshtuar. Andaj mungesa e pranimit të detyrimit që rrjedh nga këto fatura nga debitori pa kundërshtim, i bën të njëjtat të papërshtatshme për përmbnim, për çka gjykata e shkallës së parë ka vendosur që të refuzoj propozimin e kreditorit për nxjerrjen e një ekspertize financiare për konstatimin e lartësisë së borxhit. Tutje gjykata ka arsyetuar se përkundër që dokumentet e besueshme të paraqitura nga kreditori si në propozimin për përmbnim janë pranuar formalisht nga debitori përmes vënies së vulës së pranimit të tyre, të njëjtat janë kundërshtuar nga

debitori menjëherë përmes aplikimit të penalteteve kontraktuese në lartësinë e faturave, andaj si të tilla, nuk mund të shërbejnë si bazë për lejimin e përmbarrimit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se faturat pjesë e propozimit për përmbarrim, të lëshuara nga ana e kreditorit nuk përmbajnë nënshkrim dhe vulën e debitorit. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore të nenit 29 paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, i cili përcakton se: *Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës*”, kurse me paragrafin 3 të të njëjtit nen përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Mbi bazën e këtyre dispozitave ligjore, kjo gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se faturat (si në propozim) si dokumente të besueshme mbi të cilat është iniciuar procedura përmbarrimore, respektivisht është lejuar përmbarrimi nuk i plotësojnë kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat nuk e përmbajnë nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbarrueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Që nënkupton se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbarrues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbarrimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbarrimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbarrimore organi përmbarrues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbarrimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Organi përmbarrues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrtton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e

dokumentit përmbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë duke shqyrtuar pretendimet ankimore të autorizuarit të kreditorit, vlerëson se janë tërësisht të paqëndrueshme pretendimet e autorizuarit të kreditorit lidhur me rregullsinë e faturave, për faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me fatura të cilat derivojnë nga Kontrata Kornizë për Mirëmbajtjen Hixhienike të Hapësirave në objektin e debitorit, në të cilin raport kreditori ka të drejtë të arkëtimit të borxhit me faturë vetëm nëse fatura dëshmohet se është pranuar në mënyrë të rregullt. Në rastin konkret nga provat shkresore nuk mund të vërtetohet që faturat pjesë e propozimit për përmbarim janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se faturat janë dorëzuar te debitori pasi që të njëjtat nuk përmbajnë nënshkrimin e personit të autorizuar dhe as vulën e pranimit dhe si të tilla nuk janë të përshtatshme për përmbarim

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore të palës ankuese, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së dytë  
K.Dh.Sh.II.nr.1420/2023, me datë 22.03.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha